



Pranuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivery	01-12-2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinita Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHAK	7195/2023		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1296/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga:** Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas ankesës A.nr.1296/2023, të datës 17.10.2023, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat kundër organit të punësimit: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.9, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.11.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**Pezullohet procedura administrative e filluar sipas ankesës me numër A.nr.1296/2023, të datës 17.10.2023, të parashtruar nga ankuesi.**

**A r s y e t i m**

Ankuesi (*më tej referuar ankuesi*), më datë 17.10.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e regjistruar nën shenjen A.nr.1296/2023, kundër Vendimit me Nr.01/962-2023 të datës 18.09.2023 të Kryesuesit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me pretendimet ankimor se vendimi i kundërshtuar është nxjerrë me shkelje të dispozitave ligjore dhe procedurale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.10.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ndërsa, kjo e fundit, me datë 26.10.2023, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale lidhur me këtë çështje administrative.



**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokoll 6566/2023 të datës 17.10.2023, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.01/962-2023 të datës 18.09.2023 të Kryesuesit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Vendimin me Nr.809-2020 të datës 24.09.2020 të Kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Vendimin me Nr.770-2020 të datës 04.09.2020 të Kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit të datës 01.12.2008 në KQZ; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit të datës 02.12.2010 në KQZ; Akt emërimin e ankuesit me Nr.855-2011 të datës 15.07.2011 në KQZ; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të ankuesit me Nr.1528-2017 të datës 24.08.2017; Ankesën e ankuesit me Nr.02/990-2023 të datës 29.09.2023 e parashtruar tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në KQZ; Vendimin me Nr.08-27-1017-2023 të datës 05.10.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në KQZ; Komunikimet elektronike përmes e-mailit zyrtar të datës 16.08.2023, 17.08.2023, 12.09.2023 ndërmjet Udhëheqëses së Divizionit për Personel dhe Shërbime të Përbashkëta; Formularin e vlerësimit të kryerjes së punës të ankuesit për periudhën nga data 24.09.2022 deri më 24.09.2023 të datës 15.09.2023 dhe 18.09.2023 nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; Autorizimin e datës 11.10.2023 të përfaqësuesit me autorizim të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.10.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 26.10.2023 nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës dhe atë: Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit të datës 15.0.2007 në KQZ; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit të datës 01.12.2008 në KQZ; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankuesit të datës 02.12.2010 në KQZ; Vendimin me Nr.286-2018 të datës 09.03.2018 të Kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Kryeshef Ekzekutiv të SKQZ-së; Procesverbalin e datës 05.10.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në SKQZ; Formularin e vlerësimit të kryerjes së punës të ankuesit për periudhën nga data 24.09.2021 deri më 23.09.2022 të datës 14.09.2022 nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vendimin A.nr.287/2020 të datës 03.12.2020 të KPMSHCK-së; Aktvendimin A.nr.2132/2020 të datës 14.12.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin A.nr.2132/2020 të datës 17.05.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, Ankesa e KPMSHCK-së me numër të protokollit 4529/2023 të datës 31.05.2023 ndaj Aktgjykimit A.nr.2132/2020 të datës 17.05.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas administrimit të provave të ofruara nga palët në procedurë, vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për pezullim të procedurës së iniciuar sipas ankesës A.nr.1269/2023 të datës 17.10.2023, *sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, ka kundërshtuar ligjshmërinë e Vendimit Nr.01/962-2023, të datës 18.09.2023, të Kryesuesit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përmes të cilit vendim ankuesit i është vazhduar mandati në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv në Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për periudhën një (1) vjeçare, duke pretenduar se ky vendim është në kundërshtim të plotë me nenin 42 paragrafin 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik i aplikueshëm në këtë periudhë.

Kolegji i Këshillit nga provat e lëndës ka gjetur se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (tutje KQZ) më datë 25.06.2020, kishte shpallur Konkursin KQZ-35/2020, për pozitën *Kryeshef Ekzekutiv* i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me ç ‘rast si kandidat i suksesshëm për këtë pozitë



të punës ishte vlerësuar ankuesi, duke u emëruar me Vendimin numër 770-2020 të datës 04.09.2020 të kryetares së KQZ-së, Kryeshef Ekzekutiv në Sekretariatit e KQZ-së.

Duke vendosur sipas ankesës A.nr.287/2020, të datës 07.10.2020, të kandidatit Yll Buleshkaj, kandidat pjesëmarrës në procedurën e rekrutimit për pozitën Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së, Këshilli me Vendimin A.nr.287/2020 të datës 03.12.2020, ka shfuqizuar Vendimin me numër 1051-2020, të datës 05.11.2020, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të KQZ-së, si dhe ka anuluar Vendimin me Nr.770-2020 të datës 04.09.2020 për emërimin e ankuesit Kryeshef Ekzekutiv të KQZ-s dhe Konkursin KQZ-35/2020 të datës 25.06.2020, për pozitën Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së, mbi bazën së procedura e përzgjedhjes së Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të KQZ-së është përcjellë me shkelje procedurale dhe materiale.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Këshillit A.nr.287/2020 të datës 03.12.2020, ka hapur konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me ç'rast kjo e fundit me Aktvendimin A.nr.2132/2020 të datës 14.12.2020, ka aprovuar propozimin e paditësit, në këtë rast ankuesit, për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të Këshillit A.nr.287/2020, ndërsa, me Aktgjykimin A.nr.2132/2020 të datës 04.04.2023, ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit. këtui ankuesit, duke anuluar vendimin e Këshillit A.nr.287/2020 të datës 03.12.2020 si dhe ka lënë në fuqi masën lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të të njëjtit deri sa të bëhet i plotfuqishëm vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 31.05.2023 ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, duke kundërshtuar Aktgjykimin me numër A.nr.2132/2020 të datës 04.04.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Andaj, bazuar në ekzistimin e rrethanave faktike dhe ligjore si më sipër, dhe duke qenë se ende nuk kemi një vendim të plotfuqishëm gjyqësor lidhur procedurën e emërimit të ankuesit në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të KQZ-së, pasi që çështja është në procedurë ankimore në Gjykatën e Apelit sipas ankesës së Këshillit të datës 31.05.2023, rrethanë kjo që në vlerësimin e Kolegjit përbën çështje paraprake dhe bënë të pamundur vendosjen meritore lidhur me ankesën A.nr.1296/2023 të datës 17.10.2023, në këtë kuptim, Kolegji i Këshillit konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore për pezullimin e procedurës administrative sipas nenit 85 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht që të pezullohet procedura e vendosje meritore lidhur me ankesën A.nr.1296/2023, deri në nxjerrjen e vendimit të plotfuqishëm gjyqësor lidhur me ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit A.nr.287/2020 dhe rrjedhimisht edhe të procedurës së përzgjedhjes së ankuesit në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në të gjeturat e lartë theksuara, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konstaton se me evitim të rrethanave që kanë sjellë pezullimin e kësaj procedure, Kolegji do të vendos në mënyrë meritore lidhur me ankesën e pezulluar sipas këtij vendimi.

Siç u tha më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.




**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr. 1296/2023

**Ardita Përçuku-Shyti**

  
Procesmbajtëse



### Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit me autorizim të ankuesit avokatit
- Kryesuesit të KQZ-së;
- Njesisë së Burimeve Njerëzore të KQZ-së dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.